

FORMULARI TIP I

Date: 02/11/2018

**NJOFTIMI PËR INFORMIM NGA KËRKUESI PRANË AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT/AGJENCISË RAJONALE TË MJEDISIT DHE NJQV KU DO TË KETË VENDODHJEN INSTALIMI PËR APLIKIM PËR TU PAJISUR ME LEJE MJEDISI TË INSTALIMIT TË TIPIT A OSE B / NDRYSHIME NË FUNKSIONIMIN E INSTALIMIT TË TIPIT A DHE B**

Bazuar në Ligjin Nr. 10 431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", Ligjin Nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për Lejet e Mjedisit", Ligjin Nr. 60/2014, datë 19.6.2014 Për një ndryshim në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar dhe VKM 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja", Kreu VI "Informimi dhe pjesëmarrja e publikut për aplikimin për leje mjedisi të tipit A dhe B", pika 2, Njoftimi duhet të përmbajë këto të dhëna:

1. Informacion nëse kërkesa do të jetë për "Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B" apo "Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B"; LEJE TIPI B.
2. Të dhënat e ekstraktit të QKR-së; 'PAPMETAL' sh.p.k. NIPT K61327502B
3. Adresën e vendodhjes së instalimit; Durrës, Xhoxëtojt, Rruga Durrës-Shijak Km 3, Z. Kadastro, 2574, Nr. Pas 163/100
4. Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim; I-10.1 'Produkt i matihet dhe pajisje u.g.s nuk janë për menduar dikur jetën në Shqipëri'
5. Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues;
6. Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkuftar, kur kërkohet procedura e VNM-së në CD;
7. Konsultimet ndërkuftare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi; —
8. Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen; AKM
9. Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit; [info@akm.go.al](mailto:info@akm.go.al)

Mbah përgjegjësi për dorëzimin e njoftimit pranë NJQV-së përkatëse në 20 CD/DVD

Kërkuesi/Përfaqësuesi i shoqërisë

Përlindur Hoxha

Nr.kontakti

068 20 49129



Date 2/ 11/ 2018

## NJOFTIM

**Drejtuar :** Agjencise Kombetare te Mjedisit

**Lenda:** Kerkese per zhvillimin e procedures se degjeses me publikun

Shoqeria "PAPMETAL" Sh.p.k njofton Agjencine Kombetare te Mjedisit per zhvillimin e procedures se informimit te publikut per aplikimin per leje mjedisi te tipit B per instalimin:

"Industrite prodhuese te makinerive dhe pajisjeve", ID 10.1 Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve nqs nuk jane permendur diku tjeter ne kete Shtojce, - Kapaciteti kufi per lejet e tipit B – Te gjitha instalimet, me vendndodhje prane Brunes, Xhafzotaj, Rrashbull, Durres.

Ky njoftim hartohet Referuar VKM 419, date 25.06.2014 , Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja" te ndryshuar, kreu VI "Informimi dhe pjesemarrja e publikut per aplikimin per leje mjedisi te tipit A dhe B", bashkangjitur gjeni dokumentacionin e kerkuar, sipas pikes 2 te ketij kreu:

- a) Informacion nëse kërkesa do të jetë për "**Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B**" apo "Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B".
- b) Të dhënat e ekstraktit të QKR-së;
- c) Adresën e vendndodhjes së instalimit;
- d) Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim;
- e) Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues;
- f) Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkufitar, kur kërkohet procedura e VNM-së;
- g) Konsultimet ndërkufitare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi;
- h) Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen;
- i) Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit.

Perfaqesuesi Ligjor i Shoqerise

"PAPMETAL" Sh.p.k

Proletar Hasani



a. Kërkesa për vendosjen në funksionim të instalimit "Linjë për prodhimin, përpunimin, drejtimin, pastrimin të llamarinës dhe produkteve metalike" është për aplikim **per leje të re mjedisore të tipi B**, sipas Shtojcës 1, të Ligjit Nr. 60/2014, datë 19.6.2014 Për një ndryshim në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" të ndryshuar,  
"Industri prodhuese të makinerive dhe pajisjeve", ID 10.1 Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve nëq nuk janë përmendur diku tjetër në këtë Shtojcë, - Kapaciteti kufi për lejet e tipit B – Të gjitha instalimet.

b. **TE DHENAT E EKSTRAKTIT TË QKB-SE**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

## EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

### GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	K61327502B
2. Data e Regjistrimit	24/01/2006
3. Emri i Subjektit	PAPMETAL
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	12/01/2006
6. Kohëzgjatja	Nga: 12/01/2006
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Durrës Xhafzotaj XHAFZOTAJ Rruga Durrës-Shijak, Km.3. Zona Kadastrale 2574, Nr.Pasurie 163/100
8. Kapitali	605.000.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00
9. Objekti i aktivitetit	Tregtimi me shumicë e pakicë, import-eksport të mallrave industriale, ushqimore, pajisje elektroshtëpiake, lëndëve të para, veshmbathje, konfeksione, pajisje hidrosanitare, prodhime profile të ndryshme metalike, tuba, etj, përpunim llumarine, grumbullim, përpunim, tregtim dhe eksport skrapit, hoteleri e turizëm, bar, restorant. Ushtrimi i veprimtarisë së shoqërisë në fushën e shërbimeve portuale, detare, pastrim e mirëmbajtje të infrastrukturës portuale, pastrimi dhe grumbullimi i mbetjeve kimike dhe organike të anijeve, agjensi doganore dhe agjensi detare. Shërbime specicionere, doganore dhe detare. Shërbime të mirëmbajtjes së pajisjeve dhe mekanizmave portuale e industriale ( të të gjitha llojeve). Operacione portuale Ngarkim – shkarkim të anijeve dhe të gjitha operacionet e shërbimit që kanë lidhje me to. Veprimtari dhe shërbime logjistike Import, eksport i pjesëve të këmbimit, pajisjeve dhe mekanizmave portuale e industriale ( të të gjitha llojeve). Konsulencë portuale. Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet dhe/ose ndryshohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Për përmbyshjen e objektit të veprimtarisë, shoqëria mund të marrë pjesë në





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT


	ndërmarrje apo shoqëri të tjera që kanë objekt të njëjtë ose të përafërt me të sajtin dhe mund të kryejë direkt apo indirekt të gjitha operacionet tregtare, financiare, me karakter të luajtshëm e të paluajtshëm. Ushtrim i veprimtarisë në shërbime me porosi për të treta, në përpunimin e lëndës së parë llamarinë metalike në role, çuke e transformuar atë në Produkt të Gjatshëm si Profile tubolare metalike si dhe llamarinë metalike tabak, të formave dhe dimensioneve të ndryshme, dhënie me qira të ambienteve për ushtrim aktiviteti nga të treta.	
10. Administratori/ëz 10.1 Afati i emërimit	Proletar Hasani Nga: 30/05/2011 Deri: 23/06/2030	
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	ProletarHasani	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 253.731.158,00	Natyrë: 351.368.842,00
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarja në përqindje (%)	100,00	
- Të përfshijësuarit, (Plotësohet vetëm nëse sotëron funksion si përfshijësuar)		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: PAPMETAL Telefon: 0682075001 057520054 Të Tjera: Depozitimi i vendimit të asamblesë së përgjithshme nr.2, date 25.05.2009 për caktrimin e Z. Ramzi Sulo si ekspert për rritjen e kapitalit. Depozitimi i Vendimit nr. 5, date 29-05-2010 për caktrimin e ekspertit kontabel Z. Ramzi Sula, me nr. license 87, date 10-01-2010, për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë Depozitimi i Vendimit nr.15, date 07.03.2014 për caktrimin e Zrj. Eleda Dhima me nr. license 197, date 30.01.2009, si Eksperte Kontabel për auditimin e pasqyrave financiare 2013.	
15. Statusi:	Aktiv	

2

c. ADRESA E VENDNDODHJES SE INSTALIMIT

Emri i instalimit/impianitit <sup>1</sup>	Linje për prodhimin, përpunimin, drejtimin, pastrimin të llamarinës dhe produkteve metalike
---	---

<sup>1</sup> Përshkruaj titullin sipas kullonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Për lejet e mjedisit

<p>Adresa ku ndodhet apo do të ngrihet instalimi/impianti</p>	<p>prane Brunës, Xhafzotaj, Rrashbull, Durres ne Zonen Kadastrale Nr. 2574, Nr. Pasurie 163/100, Vol.16, Fq 203 me adrese te pasurise Stacioni Xhafzotaj, Rrashbull, Durres</p>																																																						
<p>Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4</p> 	<table border="1"> <thead> <tr> <th colspan="3">Kordinatat ku eshte instaluar Linja teknologjike</th> </tr> <tr> <th>Nr.</th> <th>X</th> <th>Y</th> </tr> </thead> <tbody> <tr><td>1</td><td>4579169.63</td><td>4376220.92</td></tr> <tr><td>2</td><td>4579202.57</td><td>4376205.61</td></tr> <tr><td>3</td><td>4579181.86</td><td>4376156.08</td></tr> <tr><td>4</td><td>4579258.42</td><td>4376121.82</td></tr> <tr><td>5</td><td>4579272.59</td><td>4376155.88</td></tr> <tr><td>6</td><td>4579268.08</td><td>4376158.62</td></tr> <tr><td>7</td><td>4579274.35</td><td>4376173.82</td></tr> <tr><td>8</td><td>4579283.63</td><td>4376170.29</td></tr> <tr><td>9</td><td>4579287.37</td><td>4376186.01</td></tr> <tr><td>10</td><td>4579175.73</td><td>4376236.82</td></tr> </tbody> </table> <table border="1"> <thead> <tr> <th colspan="3">Koordinatat e pronës ku zhvillohet veprimtaria</th> </tr> <tr> <th>Nr.</th> <th>X</th> <th>Y</th> </tr> </thead> <tbody> <tr><td>1</td><td>4579140.93</td><td>4376169.76</td></tr> <tr><td>2</td><td>4579266.48</td><td>4376114.35</td></tr> <tr><td>3</td><td>4579289.46</td><td>4376186.04</td></tr> <tr><td>4</td><td>4579164.98</td><td>4376245.94</td></tr> </tbody> </table>	Kordinatat ku eshte instaluar Linja teknologjike			Nr.	X	Y	1	4579169.63	4376220.92	2	4579202.57	4376205.61	3	4579181.86	4376156.08	4	4579258.42	4376121.82	5	4579272.59	4376155.88	6	4579268.08	4376158.62	7	4579274.35	4376173.82	8	4579283.63	4376170.29	9	4579287.37	4376186.01	10	4579175.73	4376236.82	Koordinatat e pronës ku zhvillohet veprimtaria			Nr.	X	Y	1	4579140.93	4376169.76	2	4579266.48	4376114.35	3	4579289.46	4376186.04	4	4579164.98	4376245.94
Kordinatat ku eshte instaluar Linja teknologjike																																																							
Nr.	X	Y																																																					
1	4579169.63	4376220.92																																																					
2	4579202.57	4376205.61																																																					
3	4579181.86	4376156.08																																																					
4	4579258.42	4376121.82																																																					
5	4579272.59	4376155.88																																																					
6	4579268.08	4376158.62																																																					
7	4579274.35	4376173.82																																																					
8	4579283.63	4376170.29																																																					
9	4579287.37	4376186.01																																																					
10	4579175.73	4376236.82																																																					
Koordinatat e pronës ku zhvillohet veprimtaria																																																							
Nr.	X	Y																																																					
1	4579140.93	4376169.76																																																					
2	4579266.48	4376114.35																																																					
3	4579289.46	4376186.04																																																					
4	4579164.98	4376245.94																																																					
<p>Kategoritë e aktiviteteve/veprimtarive industriale të cilat duhet të kërkojnë leje mjedisi <sup>2</sup></p>	<p>Industri prodhuese të makinerive dhe pajisjeve me ID 10.1</p>																																																						
<p>Kapaciteti i projektuar</p>	<p>Industri prodhuese të makinerive dhe pajisjeve me ID 10.1 Prodhimi i makinerive</p>																																																						

<sup>2</sup> Shkruani kodet e specifikuar në kolumnën 2 (e emërtuar ID) dhe aktivitetet e specifikuar në kolumnën 3 (Veprimtaria) të përcaktuara në Shtojcën 1 të Ligjit për Lejet e Mjedisit. Nëse instalimi përfshin disa aktivitete të lidhura me IPPC, është e nevojshme për të shënuar secilin prej tyre me një kod. Kodet duhet të jenë të ndara qartë.

dhe pajisjeve nqs nuk jane permendur diku tjetër ne kete Shtojce – Kapaciteti kufi per lejet e tipit B – Te gjitha instalimet



#### d. PERSHKRIMI I VEPRIMTARISE QE PARASHIKOHET TE ZHVILLOHET

**AKTIVITETI:** Linje per prodhimin, perpunimin, drejtimin, pastrimin te llamarinës dhe produkteve metalike

**Adresa:** prane Brunës, Xhafzotaj, Rrashbull, Durres ne Zonen Kadastrale Nr. 2574, Nr. Pasurie 163/100, Vol.16, Fq 203 me adrese te pasurise Stacioni Xhafzotaj, Rrashbull, Durres

**Subjekti:** "PAPMETAL" Sh.p.k  
**Administrator:** Proletar Hasani

##### • Hyrje

#### Profili i shoqërisë "PAPMETAL" për furnizimin për linjen e prodhimit dhe perpunimit të llamarinës

Instalimi Linje per prodhimin, perpunimin, drejtimin, pastrimin te llamarinës dhe produkteve metalike të shoqërisë "PAPMETAL" sh.p.k per siperfaqen e pronës 10645 m<sup>2</sup> me siperfaqe objekti 6378 m<sup>2</sup> është i pozicionuar ne Zonen Kadastrale Nr. 2574, Nr. Pasurie 163/100, Vol.16, Fq 203 me adrese te pasurise

Stacioni Xhafzotaj, Rrashbull, Durres. Kjo shoqëri është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, për aktivitetin që operon në fushën e Tregtimit me shumicë e pakicë, import-eksport të mallrave industriale, ushqimore, pajisje elektroshtëpiake, lëndëve të para, veshmbathje, konfeksione, pajisje hidrosanitare, prodhime profile të ndryshme metalike, tuba, etj, përpunim llamarine, grumbullim, përpunim, tregtim dhe eksport skrapit, hoteleri e turizëm, bar, restorant. Ushtrimi i veprimtarisë së shoqërisë në fushën e shërbimeve portuale, detare, pastrim e mirëmbajtje të infrastrukturës portuale, pastrimi dhe grumbullimi i mbetjeve kimike dhe organike të anijeve, agjensi doganore dhe agjensi detare. Shërbime spedicionere, doganore dhe detare. Shërbime të mirëmbajtjes së pajisjeve dhe mekanizmave portuale e industriale ( të të gjitha llojeve). Operacione portuale. Ngarkim – shkarkim të anijeve dhe të gjitha operacionet e shërbimit që kanë lidhje me to. Veprimtari dhe shërbime logjistike. Import, eksport i pjesëve të këmbimit, pajisjeve dhe mekanizmave portuale e industriale ( të të gjitha llojeve). Konsulencë portuale. Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet dhe/ose ndryshohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Për përmbushjen e objektit të veprimtarisë, shoqëria mund të marrë pjesë në ndërmarrje apo shoqëri të tjera që kanë objekt të njëjtë ose të përafërt me të sajën dhe mund të kryejë direkt apo indirekt të gjitha operacionet tregtare, financiare, me karakter të luajtshëm e të paluajtshëm. Ushtrim i veprimtarisë në shërbime me porosi për të treta, në përpunimin e lëndës së parë llamarine metalike në role, duke e transformuar atë në Produkt të Gatshëm si Profile tubolare metalike si dhe llamarine metalike tabak, të formave dhe dimensioneve të ndryshme, dhenie me qira të ambjentëve për ushtrim aktiviteti nga të treta, me NR NIPT: **K61327502B**. Prona ku është ngritur Linje për prodhimin, përpunimin, drejtimin, pastrimin të llamarinës dhe produkteve metalike është ekzistuese, në pronësi të shoqërisë “PAP METAL” Sh.p.k pajisur me Leje Ndetimi dhe leje mjedisi të tipit B me kodin III.1.B, me PN-1830-05-2011, Nr. 2946/1 Prot, datë 25.05.2011, Nr. Identifikues 203, Vendimi Nr. 19 i KSHK në emër të Shoqërisë “PAP MEETAL IMPEX” Sh.p.k e cila ka ndryshuar emrin në “PAPMETAL” Sh.p.k me numër të ceshtjes: CN-961750-12-12, datë 21.12.2012.

Sipërfaqja totale ku ushtrohet aktiviteti është 10 645 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe objekti 6378 m<sup>2</sup> e pozicionuar në Zonën Kadastrale Nr. 2574, Nr. Pasurie 163/100, Vol.16, Fq 203 me adresë të pasurisë Stacioni Xhafzotaj, Rrashbull, Durres.

#### **Informacion mbi kompaninë “PAPMETAL” sh.p.k**

Shoqëria “PAPMETAL” sh.p.k është një subjekt i regjistruar dhe zhvillon aktivitetin e saj ekonomik në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e prodhimit, përpunimit, magazinimit, pastrimit, trajtimit të llamarinave dhe produkteve metalike. Qëllimi i firmës ka qenë dhe mbetet përmbushja e kërkesave të cilësive dhe për këtë kompania ndjek dhe zbaton me rigorozitet menaxhimin e cilësive në të gjitha hallkat e proceseve teknologjike.

Për këtë qëllim, subjekti “PAPMETAL” sh.p.k referuar VKM nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja” të ndryshuar ka plotësuar Formularit e Kërkesës për tu pajisur me Leje Mjedisit të Tipit B për aktivitetin Linje për prodhimin, përpunimin, drejtimin, pastrimin të llamarinës dhe produkteve metalike, me vendndodhje në Zonën Kadastrale Nr. 2574, Nr. Pasurie 163/100, Vol.16, Fq 203 me adresë të



pasurise Stacioni Xhafzotaj, Rrashbull, Durres. Subjekti ka siguruar staf dhe pajisje profesionale per zhvillimin e ketij aktiviteti.

Vendosja e ketij instalimi ne kete zone eshte e pershtatshme per zhvillimin e ketij aktiviteti pasi nuk perben shqetesim per banoret, ambienti eshte i rrethuar dhe ndodhet larg nga objektet apo veprat hidroenergetike dhe qendrave te banuara, etj. Gjithashtu objekti i marre me qera eshte pajisur me Leje Ndetimi dhe Leje Mjedisi ekzistuese , gjithashtu ai ndodhet jashte zones urbane te Njesise Administrative Rrashbull.

**Qëllimi i këtij aktiviteti është Linje per prodhimin, perpunimin, drejtimin, pastrimin te llamarinës dhe produkteve metalike, si dhe magazinim te tyre me qellim furnizimin e tregut vendas dhe atij te huaj.**

### **2.1 Të dhëna mbi impiantin e instaluar**

Shoqëria "PAPMETAL" sh.p.k si firmë me aktivitet në fushën e veprimtarisë së prodhimit, perpunimit, trajtimit se llamarines dhe produkteve metalike, disponon impiantet/makineritë e domosdoshme për zhvillim e proceseve kryesore qe do te zhvillohen ne te gjitha hallkat e procesit teknologjik.

### **PROCESI TEKNOLOGJIK I PRODHIMIT TE PROFILEVE TUBOLARE PREJ CELIKU**

Profilet tubolare celiku prodhohen prej llamarine me karbon te markave te caktuara ne varesi te vendit te perdorimit te tyre. Lenda e pare (llamarina e celikut) pregatitet ne role te spesoreve, dimensioneve dhe tonazheve te ndryshme. Keto role realizohen me dy menyra perpunimi:

1. Perpunimi ne te ngrohte (hot rolled steel coil ose HRC)
2. Perpunimi ne te ftohte (cold rolled steel coil ose CRC)

Procesi i prodhimit te profileve tubolare prej ketyre roleve kalon ne fazat si me poshte:

- A. Prerja e rolese ne shirita me gjeresi analoge te profileve qe do te prodhohen
- B. Prodhimi i profileve tubolare prej shiritave te llamarines

#### **A. PROCESI I PRERJES SE SHIRITAVE**

Prerja e rolese se llamarines se celikut ne shirita behet ne makinerine e prerjes se shiritave. Rolete e perpunuara ne te ftohte ose CRC jane te ambalazuara me mbeshtjellje letre, kartoni dhe fletesh llamarine

Faza ne te cilat kalon prerja e llamarines ne shirita jane:

1. Pregatitja e rolese per procesin e prodhimit

Behet peshimi dhe pastrimi i rolese nga ambalazhi. Pastrimi nga ambalazhi ka te beje me heqjen e mbuleses prerj fletesh llamarine, letre dhe kartoni. Rolete HRC zakonisht nuk jane te ambalazuara. Shiritat lidhes te rolese hiqen pasi eshte vendosur ne makineri. Mbulesa e rolese dhe shiiritat lidhes kalojne ne skrap.

2. Hapja e rolese dhe shtrirja e llamarines deri tek thikat diskore

Ne kete faze behet hapje e rolese, kalimi i llamarines ne rulat drejtues 2 deri tek gershera 10 dhe prerja e ballit te llamarines per te hequr pjesen e cregullt e cila del prej procesit teknologjik te prodhimit te rolese. Kjo pjese llamarine kalon per skrap.

### 3. Prerja e llamarines ne shirita

Ketu llamarina pritet ne shirita me ane te thikave diskore 3 ne gjeresi te programuar me pare ne baze te profilave qe do te prodhohen. Per te realizuar prerjen dhe saktesine e gjerese se shiritit dhe per te ruajtur thikat anesore eshte e domosdoshme qe ne te dy anet e llamarines te hiqen 10 deri ne 15 milimetra shirit llamarine. Keta dy shirita te ngushte anesore qe mblidhen ne gropen e skrapit 4 jane mbetje te procesit teknologjik te prodhimit te shiritave dhe sit e tille kalojne ne skrap nepermjet mbledhesit te skrapit.

### 4. Mbledhja e shiritave ne mbledhes

Pas prerjes ne thikat diskore 3 shiritat kalojne ne gropen e mosbarazimit te shiritave 5, prej aty ne presen 6 dhe pastaj ne mbledhesin e shiritave 7. Ketu shiritat pas perfundimit te mbledhjes lidhen dhe hiqen prej mbledhesit, peshohen per tu magazinuar ne magazine e produktit gjysem te gatshem. Ne kete makineri lenda e pare (roleja e llamarines) u shndrua ne produkt gjysem te gatshem (shirita) dhe skrap. Perqindja mesatare e skrapit ne kete faze kap vleren 3%.

## **B. PRODHIMI I PROFILEVE TUBOLARE PREJ SHIRITAVE TE LLAMARINES**

Prodhimi i profileve tubolare realizohet ne makinerine e prodhimit te profileve. Realizimi i ketij prodhimi kalon disa stade te cilat jane:

### 1. Bashkimi i shiritave dhe akumulimi i tyre

Shiriti vendoset dhe fiksohet ne mbajtesin e shiritit 1 prej nga shpaloiset deri tek bashkuesi i shiritave 2. Ketu behet prerja e ballit dhe fundit te shiritit ne menyre qe gjate bashkimit te kokave te tyre me metoden e saldimit at ate jene vazhdim i njeri tjetrit pa formuar kend. Pjesa e prere e ballit dhe fundit te shiritit kalojne ne skrap. Pasi bashkohen shiritat mblidhen ne akumularotin e shiritave 3.

### 2. Kalandrimi i shiritit

Ketu behet kalandrimi i shiritit te llamarines duke kaluar ne tete radhe rulash 5 te cilet duke marre levizje nga transmisioni 4 i japin shiritit forme tubolare. Gjate ketij procesi si pasoje e deformimeve llamarina HRC shkeput nga siperfaqja e saj shtresen e djegur e krijuar gjate perpunimit te saj. Kjo shtrese largohet si mbetje teknologjike ne forme llumi me solucion ftohes lubrifikues. Kjo lloj humbje eshte e pa konsiderueshme ne rastin e llamarines CRC

### 3. Saldimi i tubit

Tubi i kalandruar kalon ne zonen ku behet saldimi i dy buzeve te tij. Saldimi realizohet nepermjet nje gjeneratori te frekuences se larte. Pas saldimit behet pastrimi i tegelit te saldimit me ane te dy thikave 6

ku thika e pare kryen pastrimin kryesor dhe e dyta finicionin. Ashkla e dale nga keto dy thika si mbetje teknologjike ne skrap. Prej ketu tubi i salduar kalon ne kazanin ftohes 7.

#### 4. Kalibrimi dhe profilizimi i tubit

Tubi i salduar dhe i pastruar i nenshtrohet kalibrimit te tij. Kete proces realizohet ne nje radhe rulash 8 te cilet marrin levizje nga transmisioni 4. Pas kalibrimit tubi kalon ne rulat e profilizimit ku aim err formen dhe dimesionet e duhura. Gjate ketij stadi largohet nje sasi tjeter e shtreses se djegur te llamarines sidomos ne procesin e profilizimit ku deformimet jane shume te medha. Kjo sasi largohet si mbetje teknologjike e prodhimit ne forme llumi me solucion ftohes lubrifikues.

#### 5. Prerja e profileve

Profili tashme i kalibruar dhe dimensionuar kalon tek sharra 9 e cila kryen prerjen e tij automatikisht ne gjatesine e programuar. Gjate prerjes krijohen mbetje teknologjike ne forme ashkle.

#### 6. Transportimi dhe paketimi

Profili i prere transportohet nepermjet transportuesve 10 dhe 11 ne bangon e paketimit dhe kolia e paketuar peshohet dhe transportohet me transportuesin e kolise 12.

Ne fillimin e prodhimit te cdo profile shiriti futet ne menyre manuale pa u salduar deri tek sharra, si pasoje me fillimin e prodhimit dy deri ne tre profilet e para kalojne si mbetje teknologjike ne skrap. Gjithashtu ne fillimin e prodhimit behen regjistrimet perfundimtare te rulave per drejtimin e profilit. Gjate ketij procesi krijohet nje sasi profilesh skrap ose cilesi e dyte.

Sic u pa edhe me lart ne procesin e prodhimit te profileve shiriti si lende e pare ne kete proces shnderrohet ne produkt te gatshem qe eshte profile dhe ne firo, skrap dhe cilesi e dyte. Sasia mesatare e skrapit gjate ketij procesi arrin vleren 2%.

Momentet kryesore te prodhimit te shiritave dhe profileve shoqerohen dhe me fotografi te marra gjate procesit te prodhimit

### **PROCESI TEKNOLOGJIK I PRODHIMIT TE FLETEVE TE LLAMARINES (Llamarine Tabak)**

Fletet e llamarines prodhohen ne makinerine e drejtimit te llamarines nga lenda e pare role llamarine te punuar ne te ngrohte (HRC) ose ne te ftohte (CRC)

Procesi i drejtimit te llamarines kalon ne fazat e meposhtme:

- A. Pergatitja dhe vendosja e rolese ne proces
- B. Drejtimi i llamarines
- C. Prerja dhe paketimi

- A. Pregatitja dhe vendosja e roles ne proces

Behet peshimi dhe pastrimi i rolese nga amballazhi. Pastrimi nga amballazhi ka te beje me heqjen e mbuleses prej fletesh llamarine, letre dhe kartoni (ne rolete CRC). Rolete HRC zakonisht nuk jane te ambalazuara. Shiritat lidhes te rolese hiqen pasi eshte vendosur ne makineri ne shpalosetin1. Ky pozicionohet ne menyre qe qendra e rolese te jete ne aksin e makinerise. Mbulesa e rolese dhe shiritat lidhes kalojne ne skrap.

#### B. Drejtimi i llamarines

Pasi priten shiritat lidhes llamarina hapet dhe futet ne hyrje te grupit te rulave drejtues te llamarines 2. Gjate kalimit ne rulat drejtues behen nje sere regjistrimesh te rulave ne baze te spesorit te llamarines dhe gjendjes ose mases se deformimit te saj. Kur me keto regjistrime eshte realizuar shtrirja e plote e llamarines, ajo leviz drejt bangos se akumulimit 3 deri tek gershera e prerjes 4.


#### C. Prerja dhe paketimi

Llamarina e drejtuar futet ne gershere dhe pritet balli i saj per tu pregatitur prerja automatike e fleteve. Pjesa e prere kalon si mbetje teknologjike ne skrap. Po keshtu ne skrap kalon dhe fundi i rolese. Programohen gjatesia e fleteve dhe numri i fleteve ne koli dhe makineria kalon ne procesin automatik te prerjes. Llamarina zhvendoset deri ne gjatesine e caktuar tek matesi i gjatesise 5 ku ndalet, nderkohe rulat drejtues nuk ndalen dhe llamarina e tepert mblidhet ne bankon e akumulimit 3. Me ndalimin tek matesi 5 gershera kryen prerjen e fletes dhe transportieri e con ate ne njesine e paketimit 6. Me plotesimin e numrit te fleteve per koli te programuar me pare levizja e llamarines ndalon dhe kolia transportohet ne njesine e ambalazhimit te kolise 7. Kjo procedure perseritet deri ne mbarimin e rolese. Pjesa e mbetur ne fund te rolese me gjatesi me te vogel se fletet standart kalon ne skrap.

Ne fund te procesit behet peshimi i kolive skrapit. Perqindja mesatare e skrapit ne kete proces arrin vleren 2.5%.







**Pershkrimi**

1. Role llamarine (lenda e pare)
2. Rula drejtimi
3. Thika diskore
4. Gropa e mbledhjes se skrapit
5. Gropa e mosbarazimit te shiritave
6. Prese
7. Mbledhesi i shiritave
8. Skrap
9. Shirita llamarine
10. Gershere per prerjen e fillimit dhe fundeve te roleve



### - Ndërtimi i linjës elektrike

Në varësi të llojit të impiantit dhe fuqisë së instaluar është zgjedhur edhe fuqia e transformatorit të kabinës elektrike të vendosur në afërsi të aktivitetit. Aktualisht rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike është në gjendje mjaft të mirë dhe kuadri elektrik është i plotësuar. Objekti dhe instalimet/pajisjet për Linjë për prodhimin, perpunimin, drejtimin, pastrimin të lllamarinës dhe produkteve metalike në të gjitha ambientet e tyre janë pajisur me kaseta të shpërndarjes së energjisë elektrike. Shpërndarja e rrjetit ushqyes të pajisjeve bëhet nga një panel komandimi. Për mbrojtjen nga shkarkimet atmosferike është parashikuar një rrjet tokezimi në zonën e makinerive dhe sisteme tokezimi të vecanta për çdo pajisje.

### - Rruga hyrëse për në objekt dhe rrugët e brëndshme

Objekti lidhet me rrugën nacionale Shijak – Durrës, dhe me rrugën dytesore të parces ku është ndërtuar objekti e cila komunikon me rrugën rajonale Xhafzotaj – Fllake, duke mundësuar komunikimin me akset kryesore të rrugëve. Rruga e cila të dërgon në hyrje të objektit është ekzistuese dhe në gjendje mjaft të mirë e shtruar me asfalt dhe e niveluar sipas parametrave dhe kushteve teknike, duke mundësuar levizjen e lirë të mjeteve. Gjithashtu përgjatë gjithë gjatësisë së infrastruktures së brëndshme është ndërtuar edhe rrjeti i drenazhimeve të ujrave të shiut.



**Planvendosja e impiantit e paraqitur në ortofoto.**





## Planvendosje e veprimtarise "PAPMETAL"

<https://geoportal.asig.gov.al>  
Data e Printimit: 27.10.2018

459553.041  
4576293.888

460027.641  
4576293.888



459553.041  
4577992.020


460027.641  
4577992.020

### Legjenda

— Rendi 1 (Kufiri)  
— Takatori

Sistemi koordinativ: KRGJSH  
Projektimi: KRGJSH

<https://geoportal.asig.gov.al> ofron të dhëna gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse. Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.



Kordinatat ku eshte instaluar Linja teknologjike		
Nr.	X	Y
1	4579169.63	4376220.92
2	4579202.57	4376205.61
3	4579181.86	4376156.08
4	4579258.42	4376121.82
5	4579272.59	4376155.88
6	4579268.08	4376158.62
7	4579274.35	4376173.82
8	4579283.63	4376170.29
9	4579287.37	4376186.01
10	4579175.73	4376236.82
Kordinatat e pronës ku zhvillohet veprimtaria		
Nr.	X	Y
1	4579140.93	4376169.76
2	4579266.48	4376114.35
3	4579289.46	4376186.04
4	4579164.98	4376245.94

### Distanca e Aktivitetit “Linjes teknologjike” nga objektet/veprat më të afërta

Drejtimi	Objekti	Distanca	Aktiviteti
Jug	Objekti më e afërt	55 m	Rruga “Shkozet – Shijak”
Jug	Objekti më e afërt	57 m	Subjekt privat “Karburant”
Veri	Objekti më e afërt	77 m	Magazina e subjektit “PAPMETAL”
Jug – Perëndim	Objekti më e afërt	107 m	Subjekt privat “Servis”
Lindje	Objekti më e afërt	121 m	Subjekt privat “Brunes”
Perëndim	Objekti më e afërt	51 m	Subjekt privat



Kondicionet urbanistike të objektit për Linje per prodhimin, perpunimin e llamarines dhe produkteve metalike, janë si më poshtë:

<b>Emri i Tregtar</b>	<b>“PAPMETAL” Sh.p.k</b>
<b>Siperfaqe e objektit</b>	6378 m <sup>2</sup>
<b>Siperfaqja në pronësi /qera</b>	10645 m <sup>2</sup>
<b>Veprimtaria</b>	Linje per prodhimin, perpunimin, drejtimin, pastrimin te llamarinës dhe produkteve metalike

<b>Vendodhja e Aktivitetit</b>	prane Brunës, ne Zonen Kadastrale Nr. 2574, Nr. Pasurie 163/100, Vol.16, Fq 203 me adrese te pasurise Stacioni Xhafzotaj, Rrashbull, Durres
--------------------------------	---

Në afërsi të zonës ku zhvillon aktivitetin subjekti “PAPMETAL” Sh.p.k nuk ka shkolla, vepra arti, argjinatura, linjë elektrike të tensionit të lartë dhe linjë uji që mund të dëmtohen nga zhvillimi i aktivitetit për “Linje per prodhimin, perpunimin, drejtimin, pastrimin te llamarinës dhe produkteve metalike”.

**e. PERMBLEDHJA NE GJUHE JO-TEKNIKE**

Përmbledhja duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

- **INSTALIMI DHE AKTIVITETET E TIJ;**

“Industriete prodhuese te makinerive dhe pajisjeve”, ID 10.1 Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve nqs nuk jane permendur diku tjeter ne kete Shtojce, - Kapaciteti kufi per lejet e tipit B – Te gjitha instalimet,

- **LËNDËT E PARA DHE ATO NDIHMËSE, SUBSTANCAT E TJERA DHE ENERGJIA E PËRDORUR OSE E GJENERUAR NGA INSTALIMI;**

Lendet e para qe perdoren per funksionimin e instalimit jane:

1. Profile tubolare celiku me karbon per konstuksione marka S235 JR dhe S275 JR.
2. Perpunohen fletet e llamarinave te drejtuara dhe pllaka llamarine
3. Traret e celikut
4. Lama dhe prokate celiku te dimensioneve te ndryshme.
5. Energji elektrike

- **BURIMET E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI;**

Shkarkimet kryesore në ajër – Karakteristikat e shkarkimeve (një faqe për çdo pikë shkarkimi)

Nr. Referencës së pikës së shkarkimit	1 – Linja e prodhimit te profileve tubolare
Burimi i shkarkimit	Makineria per bashkimin/saldimin e profileve tubolare
Përshkrimi	Makineria ben te mundur prerjen dhe bashkimin e profieve tubolare
Koordinatat: (GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4)	X: 4579199.27 Y: 4376162.94
Informacion mbi oxhakun Diametri Lartësia nga toka(m)	
Data e fillimit të shkarkimeve	Me miratimin nga Ministria e Mjedisit të Lejes

	së Mjedisit
--	-------------

Nr. Referencës së pikës së shkarkimit	2 – Linja e prodhimit te profileve tubolare prej shiritave te llamarines
Burimi i shkarkimit	Makineria e kthimit te shiritave te llamarines per prodhimin e profileve tubolare
Përshkrimi	Kjo makineri ben te mundur kthimin e shiritave te llamarines dhe prodhimin e profileve tubolarre
Koordinatat: (GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4)	X: 4579225.76 Y: 4376148.97
Informacion mbi oxhakun Diametri Lartësia nga toka(m)	
Data e fillimit të shkarkimeve	Me miratimin nga Ministria e Mjedisit të Lejes së Mjedisit

Nr. Referencës së pikës së shkarkimit	3 – Linja e prodhimit te fleteve te llamarines (llamarine tabak)
Burimi i shkarkimit	Makineria per prodhimin e llamarines tabak
Përshkrimi	Procesi eshte ai i prodhimit te llamarines tabak
Koordinatat: (GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4)	X: 4579255.02 Y: 4376137.54
Informacion mbi oxhakun Diametri Lartësia nga toka(m)	
Data e fillimit të shkarkimeve	Me miratimin nga Ministria e Mjedisit të Lejes së Mjedisit

Shkarkimet e zhurmës – Përmbledhje e listës së burimeve të shkarkimit të zhurmës

Burimi i shkarkimit	Nr. Ref. i pikës së shkarkimit	Koordinatat sipas sistemit GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4	Presioni akustik <sup>1</sup> (dBA) duke ju referuar distancës
Hyrje	1	X: 4579169.01 Y: 4376188.36	55



Linja e prodhimit te profileve tubolare	2	X: 4579199.27 Y: 4376162.94	60
Linja e prodhimit te profileve tubolare prej shiritave te llamarines	3	X: 4579225.76 Y: 4376148.97	65
Linja e prodhimit te fleteve te llamarines (llamarine tabak)	4	X: 4579255.02 Y: 4376137.54	60
Magazina	5	X: 4579236.68 Y: 4376197.54	55

- **KUSHTET NË VENDNDODHJEN E INSTALIMIT DHE RASTET E NJOHURA HISTORIKE TË NDOTJES;**

Zona ku do te zhvillohet aktiviteti Linje per prodhimin, perpunimin, drejtimin, e llamarinës dhe produkteve metalike ndodhet prane Brunës, ne Zonen Kadastrale Nr. 2574, Nr. Pasurie 163/100, Vol.16, Fq 203 me adrese te pasurise Stacioni Xhafzotaj, Rrashbull, Durres.

• **Identifikimi i ndikimeve ne mjedis dhe masat per minimizimin e tyre**

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise e cila mund te kete impakt te drejtperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i pranueshem.

Nje nga objektivat e ketij raporti eshte identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen ne njerën prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi objekti eshte i ndertuar dhe ndikimi ne mjedis do te jete vetem nga funksionimi i paisjeve dhe makinerive te linjes per prodhimin, perpunimin, drejtimin, e llamarinës dhe produkteve metaike. Nuk marrin ne konsiderate fazen pas perfundimit se veprimtarise pasi ky projekt do te vazhdoj te jete i tille dhe pas shume kohesh. Disa prej ndikimeve kryesore qe jane vleresuar si te mundshme jane paraqitur si me poshte.

Efektet e mundshme nga aktiviteti qe ushtrohet do te vleresohen ne menyre te pergjithshme ne kete formular kerkese per leje mjedisi tipi B. Megjithate, shume nga efektet e mundshme mund te identifikohen per arsye te eksperiences nga nen-projektet e projektet e meparshme ne kete fushe.

- **Impakti ne mjedis i ketij impianti dhe menaxhimi i tij**

Ne vijim do te paraqesim nje permbledhje te efekteve negative mbi mjedisin te cilat lidhen me Linje per prodhimin, perpunimin, drejtimin e llamarinës dhe produkteve metalike gjate fazes operative sebashku me rekomandimet mbi menaxhimin e tyre.

Ceshtjet e mjedisit te lidhura me fazat e prodhimit dhe perpunimit te llamarines dhe produkteve metaalike ne llogjiken e ciklit te jetes se produktit perfshijne:

- Praktikate qe qendrueshme: Impakti me i madh mjedisor si perdorimi i llamarines dhe profileve tubolare ne proceset e linjes teknologjike konsiston ne menaxhimin e lendes se pare duke maksimizuar perdorimin e lendeve te para.

- Praktika te qendrueshme ne menaxhimin e lendes se pare gjate magazinimit dhe perdorimin sa me eficient te saj gjate procesit te perpunimit, duke riperdorur dhe ricikluar ate sasi te mbetjeve te skrapit (firot) qe gjenerohen nga procesi teknologjike.

Praktika te qendrueshme ne reduktimin e emetimeve ne ajer dhe zhurmave qe gjenerohen nga vendosja ne funksionim te instalimeve.

#### - **Shkarkimet ne ujera**

Shkarkimet ne ujera vijne nga:

- a) Ujerat e perdorura per qellime sanitare dhe pastrimin e ambienteve te kapanonit.

Lidhur me ujerat qe vijne nga perdorimi sanitar, ato nuk duhet te perzihen me ujrat teknologjike, por kalojne ne grope septike e cila eshte e ndertuar prej betoni dhe kryhet filtrimi natyror i ujrave sanitare. Gjithashtu pergjate gjithë gjatesise se objektit eshte ndertuar rrjeti i drenazhimit te ujrave te shiut, te cilat grumbullohen dhe perfundojne ne pusetat e dekantimit, nga ku me pas perfundojne ne rrjetin e kanalizimeve te zones.

Nje sasi e caktuar e ujit mbahet gjithmone ne gadishmeri per rastet emergjente te objektit per mbrojtjen nga zjarri.

Duke marre ne konsiderate respektimin e kushteve teknike ne kete objekt, mundesite e ndotjes nga rastet e emergjencave jane te rralla.

Ndikimi i ketij aktiviteti ne ujera konsiston ne gjenerimin e ujrave te larjes se ambienteve dhe ujrave te shiut, ku ndikim eshte krejtesisht i lokalizuar.

Per sa i perket ujrave teknologjike, nuk kemi shkarkime pasi nuk kemi perdorim te ujit gjate procesit te prodhimit dhe perpunimit te llamarines dhe produkteve metalike.

#### - **Ndotja e tokes**

Nga procesi i magazinimit, prodhimit, perpunimit te llamarines dhe nga procesi i transportimit te produkteve te prodhuara, nuk kemi ndotje te tokes, pasi ne asnje rast nuk depozitohen mbetje apo te kemi raste te rrjedhjes se lendeve te pare. I gjithë procesi realizohet brenda objektit dhe eshte nje cikel i mbyllur qe kalon ne disa hallka.

Automjetet dhe makinerite jane te kolauduara nga Qendra e Kontrollit Teknik te Automjeteve. Mundesia e ndotjes nga rrjedhjet eshte pothuajse zero. Automjeteve duhet tu kryhet pastrimi ne menyre periodike per te mos mbartuar papasterti te lendeve qe transportojne.

#### - **Ndotja e ajrit**

Ndotja e ajrit vjen si pasoje e shkarkimeve nga makinerite e instaluara, kjo ndotje eshte krejtesisht e lokalizuar dhe per kete jane marre masat e nevojshme nga shoqeria "PAPMETAL".

Shkarkimet ne ajer jane minimale, ato krijohen si pasoje e kthimit te profileve duke qene se kerkohet ushtrimi i persionit te larte nga vete makinerit duke bere ne kete menyre clirim te energjise, energji e cila shoqerohet me clirimin e aromave dhe gazrave, si dhe gjate procesit te bashkimit te profileve tubolare.

Ne te gjithë gjatesine e objektit eshte llogaritur vendosja e aspiratoreve si dhe kryhet ventilimi natyral i objektit ku jane instaluar linjat teknologjike.

- **Zhurmat dhe vibrimet**

Zhurmat qe prodhohen vijne kryesisht nga makinerite prerese te profileve dhe llamarines.

Proçesi i prodhimit shoqerohet me clirim zhurme por nuk vleresohet ne nivele te larta e shqetesuese per zonen, vetem per ambientet e punes. (per kete subjekti duhet te kryeje nje testim nga laboratore te akredituar). Niveli maksimal varion 75.7dBA dhe 73.7 dBA.

- **Ndikimi ne toke**

Proceset e punes nuk ndikojne ne toke per shkak te ambjanteve te pershtatshme e bashkekohore, te shtruara me beton dhe kapanone te mbuluara.

- **Ndikimi ne Biodiversitet**

Kjo zonë nuk bënë pjesë në zonat e mbrojtura me ligj, lloji i aktivitetit per vendodhjen qe ka nuk ndikon ne demtimin e biodiversitetit te zones. Aktiviteti ndodhet ne nje zone me zhvillim intensiv urban dhe pjeserisht industrial.

- **Ndikimi ne Mjedisin Social**

Ndikimi i ketij aktiviteti ne mjedisin social, eshte pozitiv persa i perkete punesimit, sherbimit te shtijes se profileve, konkurrences ne treg dhe uljes se cmimeve nga shitja direkt nga pika e shumices, vete prodhuesi, etj.

- **Mbetjet e prodhuara**

Mbetje te ngurta prodhohen, llojet e mbetjeve jane copa metali alumini, xingatoje, hekuri, teli, pluhur metali, tallash, mbetje druri, plastike, qese dhe kartona nga ambalazhet, etj. Mbetje te tjera mund te vleresohen ato urbane nga aktiviteti human. Nuk vleresohet aktivitet me mbetje te ngurta, pasi materiali eshte 100% i perdorshem, per te gjitha fraksionet.

Referuar kartes teknologjike te shoqerise, rezulton se sasia e gjenerimit te mbetjeve nga procesi eshte shum e vogel 2-3% per secilen nga makinerite e instaluar.

Mbetjet e skrapit dhe ambalazhit grumbullohen nga operator te licencuar me te cilat shoqeria ka nenshkruar kontratat e sherbimit per evadimin e mbetjeve.

- **Mbetjet e ngurta urbane dhe industriale**

Mbetjet qe gjenerohen nga procesi i prodhimit dhe perpunimit te llamarines dhe nga aktiviteti i perditshme i aktiviteti te punonjesve konsistojne ne gjenerimin e mbetjeve urbane nga punonjesit. Mbetjet urbane grumbullohen ne fraksione te ndara duke perdorur sistemin me tre kosha te 1-leter dhe karton, plastike dhe qelqe, 2-metale, kanace etj dhe 3- te thata dhe te kompostueshme. Ndersa mbetjet e gjeneruara nga proceset industiale grumbullohen, transportohen dhe asgjesohen ne menyre perfundimtare nga subjekte te licencuara.

- **TEKNOLOGJIA DHE TEKNIKA TË TJERA TË PROPOZUARA PËR PARANDALIMIN E SHKARKIMEVE OSE, KUR KJO NUK ËSHTË E MUNDUR, PËR PAKËSIMIN E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI, VEÇANËRISHT DUKE ZBATUAR TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME;**

Masat e propozuara për mbrojtjen e mjedisit nga secili ndikim negativ

<b>Rekomandime për zbutjen e ndikimeve</b>	
<b>Toka</b>	
<b>Përdorimi i Tokës</b>	Kryerja e aktivitetit brënda koordinatave dhënë në relacion. Rrespektimi i kushteve teknike dhe standarteve.
<b>Erozioni</b>	
<b>Mbrojtja nga erozioni</b>	Zbatimi rigoroz i masave teknike për operimin e linjës së prodhimit, perpunimit se profileve të llamarines dhe produkteve metalike Pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave të shiut dhe ujrave të pastrimit/sanitare. Mbjellja e fidanëve përreth perimetrit të objektit në përdorim, me qëllim mbrojtjen e kompaktësisë së tokës. Mirembajtja e bazamentit ku janë të instaluar linja e prodhimit, perpunimit se profileve të llamarines
<b>Biodiversiteti</b>	
<b>Vegjetacioni Dëmtim potencial i vegjetacionit</b>	Mirëmbajtja e kurorës së pemëve dhe bimësisë së mjedisit në përdorim nga shoqëria. Mbjellja e fidaneve të rinj, përgjatë rrugës që bëhen të mundur hyrjen për në objekt.
<b>Cilësia e ajrit</b>	
<b>Rritje e emetimeve në ajër nga funksionimi i linjës së prodhimit dhe perpunimit të profileve të llamarines dhe djegia e karburantit të automjeteve ngarkim-shkarkimit</b>	Mirembajtja e instalimeve dhe ndërrimi periodik i filtrave elektrostatik sipas kapacitetit mbajtes. Mjete me kolaudim optimal. Pjesë këmbimi rezerve brënda objektit për raste emergjente. Plan veprimi në rast rrjedhjesh. Përdorimi eficient i mjeteve motorrike. Përdorim i karburantit cilësor. Pastrim periodik i objektit të zonës në shfrytëzim dhe mjeteve të punës. Pastrimi periodik i linjës teknologjike, duke mbarëvajtur operimin optimal të tij.
<b>Sistemi i drenazhimit</b>	
<b>Sistemi i drenazhimit</b>	Mirembajtja e sistemit të drenazhimit të ujrave të shiut dhe ujrave të pastrimit përgjatë gjithë gjatësisë së objektit, bashkimi i tyre në një vaske dekantimi të përbashkët dhe riciklimi, ripërdorim i ujrave.
<b>Mbetjet</b>	

<b>Shtim i mbetjeve industrial dhe urbane nga aktiviteti human i punonjësve që do të operojnë në objekt.</b>	Vendosja e kontenierëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre në venddepozitim më të afërt të caktuar nga njësia vendore. Asgjesimi i mbetjeve që vijnë nga linja teknologjike, nga kompani të licensuara.
<b>Zhurmat</b>	
<b>Rritje e nivelit të zhurmave nga impianti dhe nga lëvizja e automjeteve</b>	Përdorimi i mjeteve të kolauduara. Përdorim i linjës së prodhimit dhe perpunimit të profileve metalike brenda orareve të caktuara, nga rregullorja e punës. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse nga punonjësit (kufje për mbrojtjen e aparatit të dëgjimit). Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjat orareve të përshtatshme.
<b>Trafiku rrugor</b>	
<b>Trafiku Rrugor Rritje e fluksit të qarkullimit të automjeteve</b>	Lëvizshmëria do të studiohet të kryhet në oraret ku shmanget piku i trafikut. Mjetet e transportit do të levizin brenda normave të lejuara të shpejtësisë, referuar Kodit Shqiptar Rrugor.

- Ndjekja e gjithë kërkesave ligjore për veninë në funksion të aktivitetit duke mbajtur parasysh kufizimet dhe detyrimet kundrejt shtetit dhe paleve të treta.
- Aktiviteti kryesisht do të zhvillohet në ambjent të mbyllur kështu që nuk do të ketë nivele zhurmash domethënëse për zonën përreth. Do të bëhet pajisja e punonjësve me mjete mbrojtëse personale.
- Kompania ka ndërtuar sistemin për ripërdorimin e ujërave të pastrimit dhe krijimin e një cikli të mbyllur.
- Nga ky aktivitet nuk parashikohen të ketë ndikime në ndryshimin e habitateve
- Rikuperim dhe asgjesim i mbetjeve të rrezikshme nga subjekte të licensuara.
- Mbetjet e gjeneruara nga punonjësit do të grumbullohen në kazan të vecantë. Kazanet do të zbrazen rregullisht dhe mbetjet do të hidhen në vendin e përcaktuar nga Njësia Vendore Rrashbull për mbetjet urbane. Mbetjet e paketimit do të mbledhen dhe dorëzohen në kompani të licensuar për përdorimin, riciklimin apo trajtimin e tyre.
- Do të ndiqen gjithë rregullat e sigurimit teknik në punë si dhe pajisjes së punonjësve me uniformat dhe mjetet e nevojshme të mbrojtjes në punë.

**Për më tepër rekomandimet për të parandaluar dhe kontrolluar rrezikun e ndotjes përfshijme:**

- Mbetjet urbane të grumbullohen transportohen dhe depozitohen në oraret e caktuara nga Njësia Vendore.
- Të realizohet ndriçimi përreth (vendosja e impiantit të ndricimit).
- Të kryhet rregullimi i territorit në përputhje me kondicionet urbane të përcaktuara.
- Shoqëria të operojë në përputhje të plote me normat që janë në fuqi, dhe të kryej monitorime të vazhdueshme të tregueseve mjedisore të trysnise në mjedis.
- Të respektoje të gjitha rregullat e mbrojtjes kundër zjarrit gjatë operimit në ndërtesë dhe të respektojë rregulloren e MKZ.

- Te instalohen dhe te respektohen sinjalistikat e trafikut te cilat do te minimizonin impakti per aksidente te mundshme.
- Per te minimizuar impaktin ndaj zhurmave dhe vibrimeve, te limitohen proceset e zhurmshme gjate oreve me te ndjeshme, ndermjet ores 20 deri ne 07 te mengjesit.
- Te respektoje te gjitha masat e percaktuara ne kete Formular Kerkese per tu paisur me Leje Mjedis Tipi B.
- Te respektoje te gjitha kushtet dhe masat qe do te vendosen nga AKM-ja dhe Ministria e Mjedisit.

Nga vleresimet e mesiperme, shkarkimet e prishme ne mjedis jane te uleta dhe nuk perbejne problem serioz per mjedisin. Megjithatë perparësitë që ka ky aktivitet, duhet të tregohet kujdes në menaxhimin dhe mbajtjen nën kontroll të kushteve teknike për të minimizuar humbjet aksidentale ose shkarkimet.

**- ALTERNATIVËN NË LIDHJE ME ZGJEDHJEN E VENDIT TË INSTALIMIT DHE TEKNOLOGJINË E PËRDORUR;**

Prona ku është ngritur Linje për prodhimin, përpunimin, drejtimin, pastrimin të lëngut dhe produkteve metalike është ekzistuese, në pronësi të shoqërisë "PAP METAL" Sh.p.k pajisur me Leje Ndetimi dhe leje mjedisi të tipit B me kodin III.1.B, me PN-1830-05-2011, Nr. 2946/1 Prot, datë 25.05.2011, Nr. Identifikues 203, Vendimi Nr. 19 i KSHK në emër të Shoqërisë "PAP METAL IMPEX" Sh.p.k e cila ka ndryshuar emrin në "PAPMETAL" Sh.p.k me numër të çështjes: CN-961750-12-12, datë 21.12.2012.

Sipërfaqja totale ku ushtrohet aktiviteti është 10 645 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe objekti 6378 m<sup>2</sup> e pozicionuar në Zonën Kadastrale Nr. 2574, Nr. Pasurie 163/100, Vol.16, Fq 203 me adresë të pasurisë Stacioni Xhafzotaj, Rrashbull, Durres.

**- MASAT PËR PARANDALIMIN DHE RIKUPERIMIN E MBETJEVE (NËSE ËSHTË E NEVOJSHME);**

**Plani i Menaxhimit të Mbetjeve**

Aktiviteti që zhvillon shoqëria "PAPMETAL", në Fshati Xhafzotaj, Rrashbull, Durres nga proceset e ndryshme të operimit të punës në objekt për prodhimin, përpunimin e produkteve metalike dhe lëngut gjenerohet një sasi mbetjesh.

Rrymat prioritare të mbetjeve të gjeneruara në objekt dhe nga linja e përpunimit dhe prodhimit të lëngut, ndahen sipas fraksioneve të mëposhtme:

- Mbetje ferrose nga procesi i prerjes së profileve
- Mbetje tallazhi nga proceset e kombinimit të elementeve
- Mbetje të ngurta urbane ( Mbetjet të ambalazhit, karton, plastik, kanaçe, etj)

**Qëllimi i menaxhimit të mbetjeve:** Diferencimi i mbetjeve të gjeneruar brenda objektit të shfrytëzuar, sipas fraksioneve kryesore nëpërmjet instalimit të sistemit me 3-Kontenier, reduktimin e mbetjeve nga proceset e prodhimit, riciklimin dhe asgjësimin e mbetjeve dhe transportimi periodik të mbetjeve urbane në vendin e caktuar nga njësi vendore Rrashbull, përmes bashkëpunimit me NJQV-në, për



firmat e kontraktuara në grumbullimin e mbetjeve urbane, reduktimin dhe riciklimin e mbetjeve të aluminit, në ndërtimin e një infrastrukture të qëndrueshme në diferencimin e mbetjeve, duke maksimizuar dobinë e Landfillit Rajonal Durres (ku kryhet dhe asgjësimi përfundimtar i tyre, sipas Strategjisë Kombëtare të Mjedisit për Menaxhimin e Mbetjeve).

Grumbullim, transportim dhe asgjësim përfundimtar i mbetjeve të gjeneruara, nga subjekte të licencuara.

Menaxhimi i mbetjeve brenda zones së instalimit është tërësisht i bazuar në SKMM, PKMM, PRMM dhe Planin e Menaxhimit të Mbetjeve të Bashkisë Durres.

**Objektivat afatshkurtra dhe afatmesme të planit janë si më poshtë:**

- Instalimi i sistemit me 3-kontener brenda zones ku zhvillohet aktiviteti
- Diferencimi i mbetjeve, sipas tre rrymave prioritare (Plastik, Letër/Karton, Qelq, Xhama dhe Mbetje të tjera).
- Transportimi i mbetjeve të ngurta urbane në vendepozitim të caktuar nga Njësia Vendore.
- Nëshkrimi i kontratave me biznesin e riciklimin për grumbullimin e mbetjeve të ngurta urbane që gjenerohen nga aktiviteti

**- MASA TË TJERA TË PLANIFIKUARA NË PËRPUTHJE ME PARIMET E PËRGJITHSHME QË RREGULLOJNË DETYRIMET THEMELORE TË OPERATORIT, DMTH:**

**Programi i Përmirësimit të Procesit të Punës**

Për plotësimin e kërkesave të klientëve, rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar, rritjen e masave të sigurisë gjatë procesit të operimit në prodhimin, perpunimin e profileve, mbrojtjen nga gazrat, pluhurat, zhurmat, etj, mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe komunitetit të zonës përreth, me qëllim kryesor “Mbrojtjen e Mjedisit”, reduktimin e sasisë së emetuar të PM10, CO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, SO<sub>x</sub> në atmosfere, përdorimin e energjisë në mënyrë eficiente, duke menduar për gjeneratat e brezave pasardhës, subjekti “PAPMETAL” Sh.p.k, me përfaqësues ligjor Z. Ploretar Hasani ka hartuar “Programin e Përmirësimit të Operimit të Proceseve Teknike të Punës”, sipas termave të mëposhtme.

Programi i përmirësimit të operimit mbështetet në këto parime të zbatueshme

<b>Çfarë</b>	<b>Masat</b>	<b>Kush i zbaton</b>
<b>Parandalim</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përzgjedhja dhe trajnimi i personelit për mënyrën e veprimit gjatë magazinimit, transportimit dhe përdorimit të teknologjisë.</li> <li>- Zbatim rigoroz i sigurimit teknik gjatë punës dhe ndërprerjes së sajë në rast avarie të mundshme.</li> <li>- Montimi i të gjithë aparateve sinjalizuese të sigurisë dhe rrjetit elektrik.</li> <li>- Tokëzimi dhe rrufe pritëse, në të gjith instalimet për të shmangur aksidente me pasoja në mjedis.</li> <li>- Pajisjet dhe aparaturat do të mbahen gjithmonë të fikura, kur nuk ka procese të operimit nga aktiviteti i perpunimit dhe</li> </ul>	Investitori, Drejtuari Teknik dhe punonjësit.

	<p>prodhimit te llamarines dhe profileve metalike.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbajtja gjithmon fikur e automjeteve gjatë procesit të ngarkimit dhe ruajtja e distances së sigurisë, gjatë operimit të punës nga punonjësit që punojne ne impiantin e perpunimit te llamarines.</li> <li>- Mbajtja e pajisjeve të nevojshme, nga punonjësit për operimin e punës, si : doreza, këpucë me veshje gome, syze për mbrojtjen e syve, maska kundra gazeve dhe pluhurave, gjatë gjithë kohës dhe proceseve që zhvillohen brenda objektit.</li> <li>- Kapja dhe pastrimi i menjëhershëm në rast derdhjesh të lubrifikantëve dhe grumbullimi i tyre në kontenier (fuçia) të mbyllura hermetikisht me qëllim asgjësimitin e tyre përfundimtar nga kompanit e nënkontraktuar.</li> <li>- Grumbullimi, diferencimi dhe transportimi i mbetjeve industrial dhe të ngurta urbane çdo ditë në fund të procesit të punës në kontenierët e vendosur nga Njësia Vendore.</li> <li>- Lyerja e ambientit të punës (zyra, magazine) dhe pajisjeve me bojë antikorrozive (kundra ndryshkut) çdo dy vite sipas një programi të veçantë, me qëllim mbrojtjen nga korrodimi.</li> <li>- Testimi paraprak i gjithë teknologjisë (instalimeve) dhe rrjetit elektrik.</li> <li>- Pastrimi periodik i vendit të depozitimit të lëndës së parë, pastrimi periodik i rretit të drenazimit të ujrave teknologjike te larjes dhe të shiut, si dhe mirëmbatja e pemëve.</li> <li>- Kolaudimi periodik i mjeteve të transportit dhe impiantit të instaluar.</li> <li>- Monitorimi periodik i parametrave mjedisor dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e shoqërisë.</li> </ul>	
<p><b>Kontroll</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kontroll i automatizuar i të gjithë linjës së instalimit, nëpërmjet programeve inxhinierike</li> <li>- Pastrimi i sheshit ku zhvillohet aktiviteti dhe atij të lëvizjes së automjeteve.</li> <li>- Pastrimi i rretit të drenazimit të ujrave teknologjike dhe ujrave të shiut përgjatë perimetrit nën administrimin e shoqërisë ku zhvillohet aktiviteti.</li> <li>- Vëzhgimi dhe kulaudimi i vazhdueshëm i të gjithë teknologjisë dhe instalimeve të projektit.</li> <li>- Përdorimi eficienti i energjisë elektrike si dhe sigurimi i ambientit të objektit me ndriçimin e duhur për zhvillimin e aktivitetit.</li> <li>- Diferencimi i mbetjeve sipas rrymave specifike që gjenerohen nga aktiviteti i përditshëm i punonjësve në territorin brenda dhe jashtë objektit ku ndodhet instalimi.</li> <li>- Monitorimi periodik i parametrave mjedisor dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e shoqërisë.</li> <li>- Sigurimi i të gjithë pajisjeve të nevojshme për riparimin, pastrimin dhe ndërhyrje në rast emergjencash.</li> </ul>	<p>Drejtuesi Teknik dhe punonjësit.</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Trajnimi periodik i punonjësve dhe njohja me planin e ndihmës së shpejtë dhe planin e përballimit të emergjencave të ndryshme.</li> </ul>	
<b>Ndërhyrje</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Riparimi i menjëhershëm i difekteve dhe avarive teknologjike</li> <li>- Mobilizimi i menjëhershëm i stafit dhe mjeteve të fikjes së zjarrit.</li> <li>- Kolaudimi dhe shërbimi i pajisjeve/aparatura nga ekspertë të licensuar, çdo fillim viti.</li> <li>- Kapja, asgjësimi i menjëhershëm në rastet e derdhjeve të lubrifikantëve dhe pastrimi i menjëhershëm i ambientit të punës me detërgjentë të posaçëm, që mund të gjenerohen nga linja e perpunimit dhe automjetet që kryejnë këtë shërbim.</li> <li>- Zëvendësimi i menjëhershëm të pjesëve të pajisjeve/aparaturave dhe mjeteve të punës, në rastet e avarive të mundshme.</li> <li>- Rigjenerimi i ambientit të dëmtuar.</li> <li>- Riparimi i menjëhershëm i teknologjisë dhe linjës teknologjike, në raste avarie të mundshme apo dëmtim të instalimeve.</li> <li>- Në rastet e avarive të ndryshme do të njoftohet i gjithë stafi i punonjësve dhe klientët e gjendur aty, me qëllim sigurimin e jetës së tyre dhe ndërhyrjen për sigurimin e automjeteve dhe pajisjeve kryesore.</li> <li>- Reduktimi i sasisë së ujrave të përdorura për qëllime sanitare, si dhe në rastet e kontaminimit me mbetje të rrezikshme izolimi i tyre në kontenier të posaçëm dhe të izoluar hermetikisht.</li> <li>- Kapja dhe trajtimi mjeksor i faunës së egër, njoftimi i organeve kompetente, për rastet e mundshme.</li> <li>- Pajisja e zones së shfrytëzuar me sinjalistikën e duhur dhe shenjat dalluese në rastet e rrezikut të mundshëm, për operimin normal të punës në objekt.</li> <li>- Njoftimi i menjëhershëm i automjeteve dhe njësive të specializuara në rast emergjencash (zjarrfikëse, autoambulanca, etj).</li> <li>- Rrethimi i perimetrit të territorit në shfrytëzim.</li> </ul>	Personeli dhe organet Shtetërore të Specializuara.
<b>Administrim</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përdorimi dhe ruajtja me përgjegjësi i të gjithë, zones, instalimeve, infrastrukturës dhe mjeteve të përshkuara më sipër.</li> </ul>	

#### **Raportimi i masa të ndërmarra për programin e përmirësimit të operimit**

Raportimi i masave që do të ndërmerren në objektin ku ndodhet instalimi për prodhimin, perpunimin, e profileve metalike dhe te llamarines, Xhafzotaj, Rrashbull, Durrës, do të kryhet nga shoqëria “PAPMETAL” Sh.p.k, sipas një kalendari dhe regjistri të veçantë, i cili do të plotësohet nga drejtuesi teknik i punës në impiant dhe do të raportohet pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, me miratimin e Përfaqësuesit Ligjor, Z. Ploretar Hasani.

**Masa të tjera lehtësuese, për funksionimin eficient dhe të sigurtë të punës në aktivitetin e prodhimit, perpunimit të llamarines dhe produkteve metalike:**

- Të mirëmbahen mjediset e gjelbëruar në mënyrë të përhershme dhe të mbillen edhe bimë decorative autoktone në kushte artificiale për të rritur koeficientin e gjelbërimit.
- Të shmanget në maksimum përdorimi i mjeteve të transportit kur nuk është e nevojshme dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona.
- Të kryhet rrethimi i objektit dhe linjës teknologjike dhe të vendosen tabela paralajmëruese për rreziqet për kalimtarët dhe punonjësit.
- Të reduktohet qarkullimi në orët e pikut të trafikut, për të mos krijuar trafik të rënduar në zonë.
- Të mos përdoren boritë e mjeteve në qendrat e banuara dhe qarkullimi të kryhet me shpejtësi të ulët.
- Të vendosen kontener për mbajtjen pastër të ambjenteve nga mbetjet urbane për numrin e punonjësve.
- Investitori të respektojë detyrimet e vendosura në Lejen Mjedisore që do të miratohet nga AKM.
- Subjekti të respektojë të gjitha masat/normat/planet/shkarkimet e deklaruar në këtë Formular-Kërkese për tu paisur me Leje Mjedisi Tipi B.
- Subjekti të jetë në dijeni dhe të azhurnohet për kuadrin ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.
- Subjekti të respektojë dhe zbatojë kushtet teknike në objekt për mbrojtjen nga zjarri dhe të krijojë infrastrukturën e nevojshme për zjarrëfikset.
- Të kryhet monitorimi i indikatorëve të mjedisit sipas ligjeve në fuqi.
- Si rezultat i realizimit të projektit nuk do të absorbohen ndikime të rëndësishme mjedisore, sociale në shëndetin e njerëzve. Për pasoj ndikimet e parashikuara mund të minimizohen duke zbatuar masat e përmendura më sipër.
- Nga analiza për identifikimin e ndikimeve rezulton se ndikimi do të jetë i drejtpërdrejtë, i shkaktuar vetëm nga linja e prodhimit dhe perpunimit të llamarines.
- Është detyrë e zbatuesve të projektit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.
- Është detyrë e Njesise Vendore gjithashtu të zbatojë rigorozisht detyrimet e përcaktuara për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.
- Është detyrë e të gjith kontraktorëve e nënkontraktorëve të ndryshëm si gjatë fazës së prodhimit të zbatojnë me kujdes detyrimet përkatëse të parashikuara më sipër.

**Masa lehtësuese të tjera të kërkuara**

- Do të bëhet një menaxhim sa më me eficient të energjisë elektrike, kjo do të çojë në uljen e ndotjeve termike të mikroklimës së zonës si dhe kursim të energjisë elektrike nga përdorimi i makinerive/impanti me eficientë.
- Përcaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën përkatëse.
- Subjekti të kryejë aktivitetin për perpunimin e llamarines dhe produkteve metalike vetëm brenda kordinatave të sipërfaqes së tokës që disponon në pronësi.
- Do të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emëtimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari të mundshme teknike të mjeteve.
- Shfrytëzimi do të bëhet në mënyrë të tillë që të shmangë në maksimum dëmtimin e burimeve ujore, devijim e rrymave ujore, erozionin dhe dëmtimin zonave përreth.

- Do të instalohet sistem i ujitjes për mjedisin përreth (varet dhe nga hapësira e planifikuar për gjelbërim si dhe pozicioni që ato do të kenë) si dhe lagia me ujë e rrugicave të brëndshme gjatë periudhës Maj-Tetor.
- Linja e prodhimit dhe perpunimit të llamarinës dhe produkteve metalike të instaluar në objekt, do të kolaudohet në mënyrë periodike nga teknikë të specializuar dhe çertifikuar për të tilla procese.
- Veglat/Pajisjet/Makinëritë e punës që shërbejnë për procese të ndryshme do të zëvendësohen me të reja, sipas jetëgjatësisë së tyre dhe efikasitetit që kanë në kryerjen e operacioneve të prodhimit dhe perpunimit
- Maksimizimi i përdorimit të lëndës së parë
- Ambienti i zyrave dhe pajisjet/mjetet në zonën e shfrytëzuar do të lyhet periodikisht me bojë higjienike dhe antikorrozive, me qëllim plotësimin e kushteve Higjieno-Sanitare.
- Do të bëhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta, të cilat do të jenë; lëndë të aballazheve, letra-kartona, si dhe lëndë organike të prodhuara nga punonjësit dhe klientat, ku këto mbetje do të transportohen rregullisht në vendin e caktuar nga Njësia Vendore, ku firma do të marrë masa për menaxhimin e këtyre mbetjeve të ngurta, do të vendosen në kosha selective sipas rrymave specifike të mbetjeve.
- Do të bëhet pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave teknologjike dhe ujit të shiut në këtë objekt ose e mjedisit përreth drejt mjedisëve të gjebruara, një mundësi e mirë dhe për vaditje dhe shmangie të derdhjes së tyre në mjedis si dhe shmangie të përdorimit të ujit të pijshëm për vaditje. Mjedis i gjelbëruar përreth do të jetë nën kujdesjen e personelit që do të punësohet vetëm për punimet agro-mjedisore të nevojshme.
- Rrjeti elektrik është togëzuar për të shmangur ndonjë shkarkesë elektrike, konform kushteve teknike,
- Zona ku do të realizohen operacioni i prodhimit dhe perpunimit të llamarinës dhe produkteve metalike është e rrethuar, me qëllim për të shmangur hyrjet e paautorizuara të individëve dhe faunës së zonës përreth.
- Janë ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme të mbrojtjes kundër zjarrit. Për të mbrojtur kundër zjarrit të mundshëm që mund të bjerë do të ruhen largësitë mbrojtëse ndaj zjarrit të objektit dhe linjës teknologjike.
- Aktiviteti i disponon infrastrukturën e nevojshme, me distancat e përcaktuara për rrugë kalim të punonjësve, automjeteve, zjarrëfiksave, etj.
- Është ndërtuar sistemi i drenazhimit të ujrave teknologjike të pastrimit dhe lëvizjes së ujërave të shiut.
- Ndërsa në lidhje me burimet e furnizimit me ujë, janë të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat gjatë një viti, veçanërisht gjatë muajve të verës, kur normalisht kërkesa është më e lartë. Furnizimi me ujë sigurohet në një nivel të tillë presioni, në mënyrë që të jetë i mjaftueshëm për të shpërndarë sasinë e nevojshme të ujit në të gjithë gjatësinë e objektit dhe instalimit, por jo aq sa të demtojë pajisjet hidraulike (efekti i grushtit hidraulik) ose të krijojë rreziqe tek impianti apo aparaturat dhe jetën e punonjësit.
- Do të bëhet trajnimi periodik i punonjësve mbi kushtet e sigurimit teknik gjatë operimit të punës, si dhe të kualifikohen stafi përgjegjës për operimin e punës në impiantin e perpunimit dhe prodhimit të llamarinës dhe produkteve metalike.



## - MONITORIMI I PLANIFIKUAR I SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.

### Qëllimet e monitorimit mjedisor

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Qëllimi i monitorimit mjedisor për linjen e prodhimit, perpunimit se profileve dhe llamarinës është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

### Objektivat e Monitorimit:

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë funksionimit të impiantit.
- Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e zhvillimeve të projektit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE.
- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin ku ndodhet objekti ku janë instaluar linja e prodhimit dhe perpunimit dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me aktivitetin e propozuar.
- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga aktorët zhvillues të aktivitetit në rajon.
- Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajon, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
- Të krijojë një arkivë (regjistër) të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
- Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar.

### Plani i monitorimit

Me qenë se kemi të bëjmë me instalime për prodhimin, perpunimin e profileve metalike dhe llamarinës, i pozicionuar në Xhafzotja, Rrashbull, Durres nevojitet një monitorim i vazhdueshëm, jo vetëm në linjen teknologjike dhe makinerite, por dhe në një zonë mbi 50m për rreth objektit ku është ndertuar linja.

Plani i monitorimit do të konsistojë në :

- Monitorimi i parametrave gjeometrike të impiantit të instaluar.
- Monitorimi i zonës së mundëshme të gjenerimit të gazrave gjatë aktivitetit të prodhimit dhe perpunimit
- Monitorimi i parametrave fizike dhe dinamike të shpërndarjes së emetimeve të gazeve dhe marrja e masave përkatëse të parashikuara në projekt, për parandalimin e tij.
- Monitorimi i sjelljes së bimësisë ekzistuese në zonën përreth objektit dhe marrja e masave për parandalimin e dëmtimit të tyre.
- Monitorimi i shkarkimit të ujrave të ndotura urbane që gjenerohen nga aktiviteti i përditshëm i operimit të punës në objekt

- Monitorimi i sipërfaqeve të mbjella, pemëve dhe bimëve të kultivuara, ecurisë normale e mbirjes dhe zhvillimit të tyre. Në rastet kur vërehet se ka demtime merren masa për zëvendësime dhe fidanë të rinj. Monitorimi i çdo sipërfaqe të mbjellë do të vazhdojë për një periudhë 4 vjecare, kohë gjatë së cilës bimët kanë një zhvillim të konsiderueshëm dhe nuk kanë më nevojë për shërbime.

### **Shkarkimet e rastit**

Ndodhin kur lendet ndotese leshohen në mjedis në mënyrë të paplanifikuar. Keto shkarkime ndodhin kur nuk ka pajisje për kontrollin e tyre. Si të tilla mund të jetë një shkarkim nga mosfunksionimi siç duhet i sistemit të filtrave është një shkarkim afat shkruar dhe menjëher duhet të nderpritet puna për riparimin e difektit.

### **Shkarkimet aksidentale**

Shkaktohen nga difektet në impiantet industriale, nga gabimet në manipulimin e pajisjeve. Keto shkarkime shkaktojnë ndotje shumë të larta, por ato ndodhin shumë rrallë.

Shkarkimet varen me shumë nga mënyra e punës së impiantit/instalimit, prandaj rezultati duhet të konsiderohet specifik për mënyrën e punës së burimit gjatë marrjes së mostres.

### **Monitorimi i burimeve të shkarkimeve të lengeta**

- Shkarkimet e lengeta mund të mos jenë homogjene, në këtë rast duhet kujdes në zgjedhjen e pikave të marrjes së mostres.
- Të njihet ecuria e procesit teknologjik
- Merren disa mostra përgjatë seksionit tërthor të tubacionit ose kanalit të shkarkimit
- Zgjidhet një zonë me përzierje të mirë
- Depozitimi i lendeve të ngurta ndikon në mostrat e marra prandaj largësia e pikës së marrjes së mostres të jetë 25 fishi i diametrit të tubacionit të shkarkimit
- Nëse nuk ka zonë me homogjenitet të përshtatshëm, mostrat të merren nga disa pika përgjatë rrymes
- Kur përberja e mostrave ndryshon me kohën, merret një seri mostrash ose një përzierje e tyre.

Objekti i vetëmonitorimit të shkarkimeve në mjedis është të evidentojë vlerat reale të treguesve mjedisorë të gjendjes, ndikimit dhe trysisë në ajër, në ujëra të brendshme, në tokë, me qëllim që, në bazë të tyre, subjekti të ndërmarë masa dhe veprime korrigjuese të përshtatshme dhe të zbatueshme për zonën ku ushtron aktivitetin. Për rastet kur ka ndotje që ndikojnë në situatën e shëndetit publik dhe në mjedis, të përcaktojë shkallën e ndotjes dhe nivelin e devijimit nga normat e lejuar, në mënyrë që programi rehabilitues të hartohet i saktë dhe masat e ndërhyrjes të jenë ato të duhurat dhe në nivelin e duhur.

Në varësi të nivelit të zhvillimit të ndikimit mjedisor, masat që ndërmeren mund të përfshijnë ndalimin/eliminimin e shkakut të ndikimit, ose mund të jenë të karakterit zbutës e reduktues.

Zgjidhja më e mirë, kur rrethanat e lejojnë, është ndalimi/eliminimi i ndotjes dhe shkaqeve të tjera.

Në përgatitjen e programit të monitorimit specialistet kanë marrë në konsideratë mundësinë për të realizuar një monitorim realist të elementeve me ndikim në mjedis.

Subjekti merr përsipër sigurimin e ecurisë normale të punës dhe ruajtjen e vazhdueshme të mjedisit deri në mbylljen e aktivitetit.

Subjekti, gjithashtu, do të ketë lidhje të vazhdueshme me Agjensinë Rajonale të Mjedisit Durrës, pranë të cilës do të informojë periodikisht për mbarvajtjen e punës si gjatë prodhimit, perpunimit të profileve metalike dhe llamarines, ashtu dhe për monitorimin e parametrave të mësipër.

#### Masat për rigjenerimin e mjedisit

Masat për rigjenerimin hap pas hapi, krahas prodhimit dhe perpunimit së produkteve konsistojnë në:

1. Krijimin e sipërfaqeve për mbjellje me bimesi
2. Mbjelljen e sipërfaqeve të reja me fidanë pisha dhe barishte të ndryshme
3. Mirmbajtjen e sipërfaqeve të mbjella
4. Kapja dhe trajtimi i gazeve/aromave që gjenerohen nga instalimet

Të dhëna lidhur me punësimin dhe specializimin e shtetasve shqiptarë

Në objekt parashikohen janë punësuar 15 punonjës, të cilët janë të specializuar në kryerjen e proceseve të ndryshme të punës për prodhimin, perpunimin e profileve dhe llamarines.

#### MONITORIMI DHE REKOMANDIME

Monitorimi i cilësisë së mjedisit mbetet një ndër çështjet parësore.

Monitorim është procesi i zbulimit të ndryshimeve nëse do të ndodhin, përcaktimit të drejtimit dhe i matjes së shtrirjes së tyre.

Procesi i monitorimit do të përqëndrohet në të gjithë fazat e zhvillimit të projektit dhe fokusohet në aktivitetet që gjenerojnë ndikime negative në mjedis në efektet e këtyre ndikimeve dhe në zbatimin e masave për zbutjen e tyre. Monitorimi do të kryhet nga vetë investori dhe në rast të pamundësisë teknike për realizimin e tyre do të kërkohet bashkëpunim i subjekteve të specializuara për fushat përkatëse.

Verifikimi i monitorimit apo auditimit do të organizohen nga institucionet administrative si AKM-ja, ISHMPUT dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit etj.

#### PLANI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS.

Meqenëse kemi të bëjmë me linjen e prodhimit, perpunimit të profileve metalike dhe llamarines, krijimin e pluhurave gjatë magazinimit, gazeve/aromave gjatë prodhimit, kërkohet monitorimi i pluhurave, i zhurmës cilesive të ujrave teknologjike të pastrimit megjithëse në kemi thënë më lart që janë minimale.

Pra monitorimi do të konsistojë në matjen e parashikuar të indikatorëve mjedisor:

<b>Nr</b>	<b>Elementi i Monitorimit</b>	<b>Frekuenca</b>	<b>Analiza</b>	<b>Përgjegjësi</b>
1	Monitorim i gjithë shkarkimeve të ujrave që shkarkohen nga instalimi	Periodike	Analize e plote. Parametrat kimike: nitrate, nitrite, BOD, COD, metale	Firma
2	Monitorim i shkarkimit të grimcave të pluhurit, gazrave gjatë magazinimit dhe procesit të perpunimit	Vazhdueshëm	Ne pika të ndryshme të linjes së prodhimit dhe perpunimit	Firma
3	Monitorim i gazeve nga mjetet e transportit	Vazhdueshëm	NOx, SOx, CO, CO2, O etj	Firma
4	Monitorim i gjendjes së	Vazhdueshëm	Aromat, temperatura,	Firma

	mekanikës dhe mundësisë për shtimin e zhurmave në punë.		pluhurat, Zhurmat dB(A)	
5	monitorimin e mbjelljes së kurorës së pemëve	Periodike		Firma
6	Sasia e lendes se pare te perpunuar/konsumuar	Periodike	Sasiore	Firma
7	Sasia e produktit te prodhuar	Vazhdueshem	Sasiore	Firma

Indikatorët e mësipërm të monitorimit janë një ndërthurje treguesish me të cilët vlerësohet shumë objektivisht trysnia që ushtron zbatimi i këtij projekti në mjedis, si dhe gjendja e mjedisit, ndikimit të funksionimit të projektit të zbatuar në këtë gjendje. Matja dhe mbledhja e të dhënave për treguesit e mësipërm është bërë konformë metodave dhe teknikave shkencore të njohura dhe të pranueshme. Të dhënat që do të mblidhen do të vihen në dispozicion të organeve shtetërore dhe të interesuarve të tjerë, gjithashtu këto të dhëna do të analizohen me qëllim përmirësimin e performances mjedisore të veprimtarisë dhe bërjen e korigjimeve të nevojshme.

Në monitorimin e sipërfaqeve të mbjella të pemëve dhe bimëve të mbjella, ecurinë normale të mbirjes dhe zhvillimit të tyre.

Në rastet kur vërehet se ka dëmtime merren masa për zevëndësimin me fidanë të rinj.

Monitorimi i cdo sipërfaqe të mbjelle do të vazhdoje për një periudhe 4 vjecare kohë gjatë së cilës bimët kanë marrë një zhvillim të konsiderueshëm dhe nuk kanë nevojë për shërbim.

#### **Objektivat kryesore të monitorimit janë:**

- Për të zbuluar ndryshimet dhe për të karakterizuar saktësisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit të burimeve.
- Për të siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) të burimeve dhe shkaqeve të tyre.
- Për të evidentuar cilësinë e mjedisve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetësor, me synim për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e tyre.
- Për të vlerësuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve për menaxhimin e burimeve natyrore.

Monitorimi është detyrë e shoqërisë investitore në nivel individual për pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 të Vendimit Nr.1189. datë 18.11.2009 "Për monitorimet në Republikën e Shqipërisë"

Frekuenca e monitorimeve do të përcaktohet në aktin e miratimit të lejes së mjedisit dhe në rast të kundert, sipas kuadrit ligjor çdo 6 muaj të kryhen matjet dhe çdo tre ose gjashte muaj të dorezohet një relacion periodik i shkurtër ku të pasqyrohen punimet e kryera të shoqëruara me foto, masat e marra për reduktimin e ndotjes në mjedis dhe menyren e zbatimit të kushteve të lejes mjedisore.

#### **Regjistimi i të dhënave mjedisore**

Për të ruajtur të dhënat mjedisore të veprimtarisë do të përgatitet dhe mbahet një regjistër i veçantë ku do të pasqyrhen të gjitha parametrat e monitoruar nga shoqëria "PAPMETAL", mirëmbajtja dhe përditësimin e regjistrit nga drejtuesi teknik i instalimit.

#### **f. KONSULTIMET NDERKUFITARE**

Zona ku zhvillohet do te zhvillohet aktiviteti nuk ka nevojë ti nenshtrohet procesit te konsultimit nderkufitar.

**g. AUTORITETI VENDIMARRËS PËR DHENIEN E AKTIT TE MIRATIMIT TE LEJES SE MJEDISIT, PROCEDURAT DHE AFATET QE NDIQEN.**

Autoriteti miratues eshte Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit firmos per miratimin apo refuzimin e aplikimit per tu pajisur me leje mjedisit te tipi B, me propozim nga Agjencia Kombetare e Mjedisit, e cila shqyrton dokumentacion e paraqitur nepermjet Qendres Kombetare te Biznesit.

Afati per marrjen ne shqyrtim te aplikimit per pajisjen me leje mjedisit te tipit B eshte 40 dite pune.

**h. ADRESA E AKM-SE, KU PUBLIKU MUND TE DERGOJE KOMENTET DHE SUGJERIMET E TIJ, ME SHKRIM APO NE FORME ELEKTRONIKE, BRENDË 20 DITE NGA DATA E NJOFTIMIT.**

Faqja zyrtare e Agjencise Kombetare te Mjedisit: [akm.gov.al](http://akm.gov.al)